REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 148/17
Date/Datum 01.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEWBODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	**148/17**
PËR:	- Zyrtarin e prokurimit të AK-së: **Komuna e Prizrenit** - Parashtruesit të ankesës: **"Sfinga" sh.p.k. - Prizren**
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrije Bullatovci - Ekspert Shqyrtues i Prokurimit Bullatovci
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar: **"Sfinga" sh.p.k. – Prizren,** me numër protokollit: **148/17**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Organizimi i manifestimeve të Qershorit", me nr. të prokurimit: 622/17/1281/221.** Kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues: (AK) – **Komuna e Prizrenit.**

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	**01.06.2017**
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Organizimi i manifestimeve të Qershorit", me nr. të prokurimit: 622/17/1281/221,** iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **Komuna e Prizrenit,** si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues: **"Sfinga" sh.p.k. – Prizren**, me numër protokollit: **148/17.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bullabai		24.05.2017		25.05.2017		01.06.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të ekspertizës*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: **19.05.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **148/17,** e parashtruar nga OE: **"Sfinga" sh.p.k. – Prizren,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Organizimi i manifestimeve të Qershorit", me nr. të prokurimit: 622/17/1281/221**, iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **"Sfinga" sh.p.k. – Prizren.**
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

Pikat e Ankesës:

- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
- Shkelje e nenit 52, pika 3, të LPP-së, Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës;
- Shkelje e nenit 54 pika 1.3 të LPP-së, Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar;
- Shkelje e nenit 59 pika 2 dhe 4 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Shkelje e nenit 60 pika 1.2 të LPP-së, Kriteret për Dhënien e Kontratës;
- Shkelje e nenit 67 pika 2 të LPP-së, Provat Shkresore.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

- AK nuk siguroj barazi por krijoj favor për një OE që nuk përmbushi kërkesat e dosjes se tenderit 9DT) të cilat i parashtruat vete ne DT, pra na diskriminoi.
- Kriteret e përcaktuara ne DT nuk marren për vlerësim edhe pse kjo u kërkohet me dispozitat ligjore (neni 52 pika e Ligjit 05/L-068).

- AK nuk kërkoj nga OE NSH SHPM "Studio Helix" me shkrim sqarime rreth lëshimeve dhe mangësive vijuese:

- Pjesa C Formulari për dorëzimin e tenderit te OE NSH SHPM "Studio Helix" nuk është plotësuar me dorëshkrim por me kompjuter; edhe pse DT u dorëzua ne meny fizike e jo elektronike.

- Paramasa Parallogarit e plotësuar nga OE NSH SHPM "Studio Helix" është plotësuar po ashtu me kompjuter e jo me dorëshkrim dhe është nënshkruar nga një nënshkrim qe nuk është identike me personin zyrtar të këtij OE. Pra nënshkrimi dallon nga ai ne Formularin C, Deklarate nen Betim dhe Pjesën II Përshkrimi i Çmimeve te cilën OE NSH SHPM "Studio Helix" e ka plotësuar dhe e ka vulose si nënshkrues.

- Ne DT faqe 12, ne kolon ku shënon Nr, nenit, ne kolonën: Kërkese mbi gjendjen ekonomike dhe financiare" pika 8.1 dhe 8.2 dëshmitë e kërkuara dokumentare: shënon: Evidenca 1: Pasqyrat financiare te kompanisë te shoqëruar me qarkulli financiare nga banka për tri vite te fundit (2014-2015-2016) apo deklarata e tatimeve vjetore te dorëzuar ne Administratën Tatimore te Kosovës. OE NSH SHPM "Studio Helix" nuk ka kurrfarë PASQYRA FINANCIARE TE KOMPNISE. Qarkullimi bankar qe e paraqet OE NSH SHPM "Studio Helix"përfshin periudhën 01.01.2014 deri me 08.03.2017. Kërkesa ne DT është 01.01.2014 deri 31.12.2016.

- Certifikata e Biznesit e OE NSH SHPM "Studio Helix" tregon se ky operator ka bere një ndryshim me 04.04.2016, respektivisht ne Regjistrimin e Agjensionit për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare-ARBK, shkuan se OE NSH SHPM "Studio Helix"ka aplikua me 29.08.2008, por është konsisto me 04.04.2016, por nuk ofrohen kurrfarë sqarime, qe lenë dyshime qe nuk ka funksion apo ka pasur emërim tjetër apo partner qe është ndare por ka patur kontrata e qarkullim te përbashkët.

- Kontratat e paraqitura nuk korrspodojn me Referencat. Kjo për arsye se ne tri (3) referenca nuk shënohet Nr. Prokurimit qe është pjese obligative por nuk shendohet as vlera e punëve te kryera, qe krijon dyshim se kontratat nuk janë realizuar ne tersi. Kjo krijon edhe dilema se a plotësohen kërkesa e DT ne vlere prej 60.000 euro për pune- projekte te ngjajsheme te natyrës se kontratës.

- Bazuar me dëshmitë e mësipërme AK ka bere shkelje te dispozitave te nenit 60 pika 1.2 dhe nenit 67 pika 2 te LPP. 04/L-042.

- Nisur nga kjo kërkojmë te OSHP te merr parasysh faktet e ofruar dhe te kërkoi nga AK qe ti respektoni dispozitat e LPP-se si dhe kërkesat qe i ka parashtrues vet ne DT, me çka do te na shpall fitues te këtij tenderi.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP:.....30.03.2017

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e Hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....Shërbime/vlerë e Mesme

Vlera e parashikuar e kontratë: .....40,000.00 Euro

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):.....21.04.2017

Data e hapjes së ofertave:.....21.04.2017

Kriteret për vlerësim:

Kriteri për dhënien e kontratës (N. 60): .....Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri (N.65-69):

- Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 .Neni 65.
- Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.
- Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush"Kërkesat e përshtatshmërisë" të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës d një dëshmi se ju keni përmbushë obligimet e tatimit në pronë së paku deri në muajin paraprak nga data e hapjes së ofertave .

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Deklarata nën betim e cila është pjesë e DT të plotësohet nënshkruhet dhe vuloset në origjinal
- Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje).
- Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).
- Vërtetimi i tatimit në pronë Dokumentet (nën b dhe dc) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzimit të dokumenteve të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar.

Kërkesat përshtatshmërisë profesional (N.66):

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe /apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit: Kërkesa
2. Regjistrimi i TVSH: Kërkesa
3. Regjistrimi i Numrit Fiskal:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1:Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje).
Evidenca 2:Certifikata e TVSH-kopje,
Evidenca 3:Certifikata e numrit

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 68 të LPP-së)

- Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjata tri viteve të fundit (2014, 2015, 2016) ka qen prej jo më pak se 80.000,00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Pasqyrat financiare të kompanisë,të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e fundit (2014-2015-2016) apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (neni 69 të LPP-së)

- Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e fundit (2014,2015 dhe 2016),e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit standardeve, dhe vlera,minimumi te jetë 60.000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, kurse kopje për dosjen në kopje fizike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo procesverbal te pranimit përfundimtar të shërbimeve (kopje).

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	N.P.T. "MD-PRODYCT"	Prizren	37,850.00 €
2.	N.SH. SHKOLLA FILLORE E MUZIKES "STUDIO HELIX"	Prizren	29,800.00 €
3.	N.SH. "A.M.C"	Prishtinë	36, 930.00 €
4.	"SFINGA" SH.P.K.	Prizren	33,333.00 €
5.	GRUPI I OE N.T.SH. "GORENJE UNIVERZAL & N.T.P. "LAS PALLMAS" & "HAJDIN BERISHA"	Suharekë	34,600.00 €

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve në hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 3 (tre) OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (neni 59)

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Sherife Qengaj, Zyrtare në DT- Kryetar,
- Përparim Shala, IDK- Anëtar
- Hasime Rashkaj, Zyrtare në DT- Anëtar.

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimit:.....27.04.2017

Data e njoftimit për dhënie të kontratës (N.41):.....08.05.2017

Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE (N. 108/A):.....12.05.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues konstatoj se 5 (pesë) operator ekonomik që kanë ofertuar, ne aktivitetin e prokurimit **"Organizimi i manifestimeve të Qershorit"**, me nr. të prokurimit: 622/17/1281/221, 2 (dy)operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa 3 (tre) operator ekonomik janë të pa përgjegjshëm pasi që nuk kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

- GRUPI I OE N.T.SH. "GORENJE UNIVERZAL & N.T.P. "LAS PALLMAS" & "HAJDIN BERISHA" Suharekë, nuk ka plotësuar kërkesat përshtatshmërisë profesional si dhe kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale teknike dhe profesionale.

- OE N.P.T. "MD-PRODYCT" Prizren, nuk ka plotësuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale teknike dhe profesionale.

- OE N.SH. "A.M.C" Prishtinë, nuk ka plotësuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale.

Duke u bazuar ne ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, komision i vlerësimit me kontratë propozon të shpërblehet OE "Studio Helix" me çmimin e ofruar prej 29,800.00€.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës Tenderime, është konstatuar, si në vijim:

Sqarimi: Nr. 1 (mbarëvajtja e procedurës së prokurimit).

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit **"Organizimi i manifestimeve të Qershorit"**, me nr. të prokurimit: 622/17/1281/221, ka aplikuar procedurën hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike, shërbime, vlerë e mesme. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sqarimi: Nr. 2

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti ka bërë shkelje të nenit 54 të LPP-së, ekspertja shqyrtues pretendimin e operatorit ekonomik ankues e kualifikon si të pa bazuar, për arsye se autoriteti kontraktues për mes letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, me dt. 08 maj 2017, e ka njoftuar operatorin ekonomik ankues ku ndër të tjera thuhet: *Ju informojmë se kontrata i është dhënë "Studio Helix" për një shumë prej 29,800.00€.*

Sqarimi: Nr. 4

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: "*Paramasa Parallogarit e plotësuar nga OE NSH SHPM "Studio Helix" është plotësuar po ashtu me kompjuter e jo me dorëshkrim dhe është nënshkruar nga një nënshkrim qe nuk është identike me personin zyrtar të këtij OE. Pra nënshkrimi dallon nga ai ne Formularin C, Deklarate nen Betim dhe Pjesën II Përshkrimi i Çmimeve te cilën OE NSH SHPM "Studio Helix" e ka plotësuar dhe e ka vulose si nënshkrues*", ekspertja shqyrtuese sqaron se çështja e plotësimit të dokumenteve nga ana e tenderuesve a duhet të plotësohet me shkrim apo me kompjuter, nuk është e rregulluar me LPP-në as me legjislacion dytësore.

Mirëpo, në nenin 45.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, sqarohet qëllimi i përdorimit të dokumenteve standarde e që është ti ndihmoj operatoret ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave.

Sqarimi: Nr. 5

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së respektivisht ku thuhet : "*OE NSH SHPM "Studio Helix" nuk ka kurrfarë PASQYRA FINANCIARE TE KOMPNISE. Qarkullimi bankar qe e paraqet OE NSH SHPM "Studio Helix"përfshin periudhën 01.01.2014 deri me 08.03.2017. Kërkesa ne DT është 01.01.2014 deri 31.12.2016*", ekspertja shqyrtuese bazuar ne shkresat e lëndës sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës në harmoni me kërkesën e specifikuar ne nenin 81. dhe 8.2 në FTD, si dëshmi ka ofruar vërtetimin e qarkullimit nga ProCredit Bank, ku totali i qarkullimit për periudhën 01.01.2014, deri me 08.03.2017, është 153,223.30€.

Sqarimi: Nr. 6

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: "*Certifikata e Biznesit e OE NSH SHPM "Studio Helix" tregon se ky operator ka bere një ndryshim me 04.04.2016, respektivisht ne Regjistrimin e Agjensionit për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare- ARBK, shkuan se OE NSH SHPM "Studio Helix"ka aplikua me 29.08.2008, por është konsisto me 04.04.2016, por nuk ofrohen kurrfarë sqarime, qe lenë dyshime qe nuk ka funksion apo ka pasur emërim tjetër apo partner qe është ndare por ka patur kontrata e qarkullim te përbashkët*", bazuar ne certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe informata mbi biznesin, ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës si veprimtari primare ka aktivitetet mbështetëse për shfaqje artistike ndërsa veprimtari sekondare ka aktivitet tjera të argëtimit dhe rekreacionit si dhe disa veprimtari tjera.

Sqarimi: Nr. 7

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: "*Kontratat e paraqitura nuk korrspodojn me Referencat. Kjo për arsye se ne tri (3) referenca nuk shënohet Nr. Prokurimit qe është pjese obligative, por nuk shendohet as vlera e punëve te kryera, qe krijon dyshim se kontratat nuk janë realizuar ne tersi. Kjo krijon edhe dilema se a plotësohen kërkesa e DT ne vlere prej 60.000 euro për pune- projekte te ngjashme te natyrës se kontratës*", ekspertja shqyrtues sqaron, lidhur me kërkesën e specifikuar në nenin 9. 1 të dëshmia dokumentare ne 9.2 të FTD-së, autoriteti kontraktues ka kërkuar të ofrohet si dëshmi: *Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, kurse kopje për dosjen në kopje fizike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo procesverbal te pranimit përfundimtar të shërbimeve (kopje).*

Ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës lidhur me kërkesën e lartë cekur si dëshmi ka ofruar: Kontratën me K. Prizrenit bashkangjitur referencën me nr. 662/16/037/221, ne vlerë prej 19,850.00€ (viti 2016); Kontratën me K. Prizrenit bashkangjitur referencën me nr. 662/16/038/221, ne vlerë prej 17,950.00€ (viti 2016); Kontratën me K. Prizrenit ne vlerë prej 21, 950.00€ (viti 2015), bashkangjitur referencën nuk ceket vlera, Kontratën me K. Prizrenit ne vlerë prej 9, 845.00€ (viti 2014), bashkangjitur referencën nuk ceket vlera.

Bazuar ne atë që tha më lartë, ekspertja shqyrtues sqaron se qëndron pretendim i operatorit ekonomik ankues, mirëpo në rastin konkret autoriteti kontraktues me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike është dashtë të veproj konform nenin 72 të LPP-së.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e **"Organizimi i manifestimeve të Qershorit"**, me nr. të prokurimit: 622/17/1281/221, si dhe duke pasur parasysh sqarimin nr. 7, i propozon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa autoriteti kontraktues të anuloj vendimin njoftim për dhënie të kontratës, të dt. 08 maj 2017, dhe lëndën ta kthej ne Rivlerësim.